Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/129
Datë: 31.03.2023

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 27.03.2023 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Akreditohet** Institucioni i Aftësimit Profesional "Akademia Evolucion", me adresën: Lagjja Lakrishtë, Rruga Tirana p.n, Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 27.03.2023 deri 26.03.2026, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   1.1 Rrobaqepësit, rrobaqepëset, gëzofpunuesit dhe kapelëbrësit, Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 9 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me pesëmbëdhjetë (15) kandidat në një grup, dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tre (3) grupe, gjithsejtë 45 kandidatë brenda vitit.

   1.2 Modelist prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë të ngjashëm, Niveli IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 26 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me pesëmbëdhjetë (15) kandidat në një grup, dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tre (3) grupe, gjithsejtë 45 kandidatë brenda vitit.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së Institucioni i Aftësimit Profesional "Akademia Evolucion", për validim, akreditim dhe rekomandimeve të dala nga raportet e vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe raportet e ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucioni i Aftësimit Profesional "Akademia Evolucion", dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Besim MUSTAFA, PhD,EDBA

~~Kryetar i~~ KD të AKK